



Organizata për  
Demokraci, Antikorrupsion  
dhe Dinjitet, Çohu!

**Kodi i  
Etikës në  
Organizatën  
ÇOHU!**



Organizata për Demokraci,  
Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!

Rruga: Fehmi Agani 21-5, Prishtinë,  
Kosovë

Tel / +383 (0)38 248 506

[www.cohu.org](http://www.cohu.org)



**Respektimi i  
kodit të etikës**

---

**1**

**Respektimi i kodit  
të gazetarisë**

---

**2**

**Trajtimi i  
barabartë**

---

**3**

**Barazia  
gjinore**

---

**4**

**Ndalimi i diskriminimit  
dhe ngacmimit**

---

# Preambula

Organizata ÇOHU! është themeluar me qëllim të luftimit të korrupsionit në Kosovë, demokratizimit të shoqërisë, përparimit të të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë,

përparimit të praktikës demokratike dhe shoqërisë civile, analizimit dhe avancimit të çështjeve socio-ekonomike në Kosovë.

## Respektimi i kodit të etikës

1.1

Ky kod rregullon normat etike të sjelljes dhe praktikës në organizatën ÇOHU!

1.2

Të gjithë punonjësit/punonjëset e organizatës janë të obliguar/a të njihen me parimet e këtij Kodi dhe të veprojnë plotësisht sipas tij.

1.3

Këtë kod janë të obliguar/a ta respektojnë të gjithë punonjësit/punonjëset e punësuar në organizatën ÇOHU!

1.4

Ky kod do t'i jepet secilit punëtor/punëtore me rastin e nënshkrimit të kontratës, do t'i dërgohet përmes e-mailit dhe do të publikohet në ueb-sajtin e organizatës.

1.5

Çdo veprim që bie në kundërshtim me këtë Kod të Etikës do të sanksionohet konform rregullores së punës së Organizatës Çohu dhe legjislacionit në fuqi.

# 1

## Kapitulli I

### Respektimi i kodit të gazetarisë

- 1.1 Të gjithë punonjësit/punonjëset e organizatës ÇOHU!, (sidomos gazetarët/et) duhet të kryejnë punën e tyre në mënyrë të paanshme, në përputhje me parimet e profesionit të një gazetari/e. Ata gjithmonë duhet t'i japin përparësi interesit publik mbi interesin privat.
- 1.2 Të gjitha raportimet që publikohen nga organizata ÇOHU!, përkatësisht nga Qendra Kosovare për Gazetari Hulumtuese, duhet të respektojnë plotësisht Kodin e Mediave të Shkruar të Kosovës, i cili është hartuar nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës.

# 2

## Kapitulli II

### Trajtimi i barabartë

- 2.1 Organizata ÇOHU! siguron dhe garanton barazi për të gjithë personat e punësuar, pavarësisht moshës, gjinisë, seksit, racës, gjuhës, përkatësisë kombëtare apo fetare, origjinës etnike, statusit shoqëror dhe ekonomik. Dallimet midis njerëzve duhet të pranohen në mënyrë të hapur dhe tolerante, duke respektuar privatësinë e punëtorëve/punëtoreve.
- 2.2 Organizata ÇOHU! zotohet se do të sigurojë dhe promovojë mundësi të barabarta punësimi për të gjithë punonjësit/punonjëset, si dhe t'i ndihmojë ata/ato të zhvillojnë potencialin e tyre përmes trajnimeve të ndryshme dhe aktiviteteve të tjera që zhvillohen në organizatë.

# 3

## Kapitulli III

### Barazia gjinore

- 3.1** Të gjithë personat e punësuar në organizatën ÇOHU! duhet të kontribuojnë për të zvogëluar, luftuar dhe eliminuar pabarazitë eventuale gjinore.
- 3.2** Organizata ÇOHU! do të monitorojë dhe ndërmarrë masa në mënyrë aktive për të siguruar përfaqësim të duhur gjinor në fushat e gazetarisë dhe fushat tjera me të cilat merret organizata.
- 3.3** Do të mundësojë dhe zbatojë meritokraci në punësim dhe në avancim në punë duke respektuar barazinë gjinore, pa ndikime, paragjykime dhe stereotipe gjinore.
- 3.4** Organizata ÇOHU! gjatë aktiviteteve të punës do të kërkojë në mënyrë aktive këndvështrimet e të gjitha problemeve sociale dhe situatave për të cilat raporton, e që kanë të bëjnë me pabarazinë gjinore. Për të arritur këtë qëllim do të përpiqet të ketë ndikim edukativ te audienca.
- 3.5** Ndalohet çfarëdo lloj prezantimi diskriminues, sidomos gjinor, stereotipizues ose fytes i personave në publikimet e organizatës, porosive në rrjetet sociale ose në çfarëdo mënyre tjetër në emër të organizatës.
- 3.6** Gazetarët/et dhe pjesa tjetër e stafit të organizatës, gjatë shkrimeve gazetareske, përkatësisht publikimit të raporteve të ndryshme, duhet të respektojnë rregullat gjuhësore për përputhjen në gjini, numër dhe rasë, dhe në këtë aspekt të përdorin gjithmonë gjininë femërore për profesionet që i kryejnë gratë aty ku është e mundur.
- 3.7** Në tekstet që publikohen nga organizata ÇOHU, duhet të shmangen shprehjet dhe termat që janë pasojë e stereotipave dhe paragjykimeve për gjininë, të tilla si polaritetet: gjinia më e bukur – më e dobët, gjinia më e butë – më e fortë, e të ngjashme si këto.
- 3.8** Në tekstet gazetareske dhe raportet e ndryshme që publikohen nga organizata ÇOHU, gazetarët/et dhe stafi tjetër i organizatës, duhet të kujdesën që të intervistojnë njohës së fushave përkatëse nga të dy seksjet, në hulumtime/raportet aty ku është e mundur.
- 3.9** Gazetarët/et dhe pjesa tjetër e stafit të organizatës, ndër të tjera, duhet të kenë në fokus edhe trajtimin e temave të ndryshme që prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë apo edhe indirekte interesat dhe nevojat e burrave dhe grave. Raportimet duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të balancuara sa i përket sfidave dhe arritjeve të grave dhe burrave.
- 3.10** Gazetarët/et dhe pjesa tjetër e stafit të organizatës, ndër të tjera, duhet të realizojnë hulumtime/raporte lidhur me dukuritë negative në shoqërinë kosovare, me theks të veçantë dhunën në familje, e veçanërisht ndaj grave, trafikimin e qenieve njerëzore, trafikimin seksual me theks të veçantë të grave. Raportimi për këto tema duhet të bëhet në mënyrë korrekte dhe profesionale, duke iu shmangur qasjes sensacionale gjatë raportimit, dhe duke respektuar privatësinë e tyre si dhe mbrojtjen e identitetit kur kërkohet nga palët për të cilat raportohet, sidomos për gratë dhe të miturit/at.



## Kapitulli IV

### Ndalimi i diskriminimit dhe ngacmimit

- 4.1** Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësorë ose cenorë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
- 4.2** Ngacmimi konsiderohet diskriminim, kur një sjellje e padëshirueshme (që përfshin por, nuk kufizohet në sjellje të natyrës së padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike, që ka për qëllim apo pasojë shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e ambientit frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fytes).
- 4.3** Ndalohet çfarëdo lloj diskriminimi ndaj punëtorëve/punëtoreve të organizatës në vendin e punës dhe gjatë realizimit të punës në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatëzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.
- 4.4** Çdo punonjës/punonjëse e organizatës duhet të trajtohet me dinjitet dhe respekt. Është e papranueshme çdo sjellje ose veprim që mund – qoftë edhe indirekte – t'i shkelë këto të drejta. Kjo në mënyrë specifike vlen për të gjitha format e abuzimit, ngacmimit dhe forma tjera të ngjashme.
- 4.5** Nuk lejohet përdorimi i toneve të larta të zërit, fjalëve të papërshtatshme dhe abuzive, e veçanërisht jo sharjet ose grindjet gjatë komunikimit mes kolegëve/kolegeve në vendin e punës dhe gjatë punës.
- 4.6** Ndalohet përdorimi i formave diskriminuese gjuhësore brenda dhe jashtë organizatës, të gjitha llojet e kërcënimeve, frikësimet, sjelljet armiqësore, presioni ose ndikimi i papërshtatshëm, komentet (vërejtjet) fyese, veprimet kundër integritetit të personalitetit, ngacmimet në vend të punës, ngacmimet seksuale dhe të gjitha format e sjelljeve të padëshirueshme fizike dhe verbale.

